

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. _____ Prot.
____/____/2020

Tiranë, _____ më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Data: 25/08/2020

Nga: Autoriteti Kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Tiranë

Për: "Vilnik Motors" sh.p.k. me Nr. NIPTI L01314031G

Adresa: Vaqarr LALM, Rruga "Kavajës", Ndërtesë 2 katëshe, Kati 2, Km 6, Tiranë

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim - Shërbime, me mjete elektronike.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Mirëmbajtje e automjeteve të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit" -Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-65946-07-20-2020

Fondi limit për njësi: 2,997,283.33 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Vlera e Marrëveshjes Kuadër është vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj: 3,600,000 (tre milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Financim nga Bashkia Tiranë në mbështetje të Vendimit Nr.157 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak të Tiranës për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020".

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 03.08.2020

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|--|--------------------------------------|
| 1. “Auto Manoku Servis” sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | L62311016C
<i>numri i NIPT-it</i> |
|--|--------------------------------------|

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 2,210,100 (dy milion e dyqind e dhjetë mijë e njëqind) lekë pa TVSH.

- | | |
|---|--------------------------------------|
| 2. “KADIU” sh.a.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | J61817045K
<i>numri i NIPT-it</i> |
|---|--------------------------------------|

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 2,928,720 (dy milion e nëntëqind e njëzetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë pa TVSH.

- | | |
|---|--------------------------------------|
| 3. “Vilnik Motors” sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | L01314031G
<i>numri i NIPT-it</i> |
|---|--------------------------------------|

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 2,832,300 (dy milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- | | |
|--|--------------------------------------|
| 1. “Auto Manoku Servis” sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | L62311016C
<i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. “KADIU” sh.a.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | J61817045K
<i>numri i NIPT-it</i> |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k., është konstatuar se:
 - Për specialitetin bojaxhi/ llamarinist është paraqitur kontratë pune, ndërsa për dëshminë e kualifikimit profesional është paraqitur çertifikatë nga “VELMAR ALBANIA” sh.p.k., e cila është e cikluar nga Ing. Artur Zeneli. Kjo çertifikatë do të ishte e saktë po të jepnin të dhëna që kjo firmë është e liçencuar nga ministritë përkatëse për dhënien e këtyre dëshmime/çertifikatave, me qëllim që nga ana jonë të bënim verifikimet e duhura për këtë dëshmi të paraqitur.
 - Në listëpagesat e dorëzuara për muajin janar 2020 nuk figurojnë i punësuar Z. Jetmir Gjoka (xhenerik) dhe Z. Erlind Dërmishi (motorrist).
 - Nuk është paraqitur dokumentacioni që ka në pronësi ose me qera paisjen për kontrollin e bllokut të cilindrit të motorit dhe testatove (për çarje).
 - Nuk janë paraqitur fotot për:

- pajisje për kontrollin e bllokut të cilindrit të motorit dhe testatove (për çarje)
- pajisje për çmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit
- pajisje për kontrollin dhe balancimin e disqeve dhe gomave të automjeteve
- Nuk ka paraqitur çertifikatat:
 - ISO 9001:2015
 - ISO 14001:2015
 - OHSAS 18001:2007 ose ekuivalenten e saj ISO 45001-2018 për aktivitetin që ushtron lidhur me riparimin e automjeteve.

Çertifikatat e paraqitura janë për firmën “Auto Manoku” sh.a. dhe jo në emër të firmës konkurrese.

- Operatori ekonomik ka paraqitur katalogun e fenelinës dhe autorizim distributori nga firma “Universal”, por pa treguar lidhjen midis firmës që ka lëshuar këtë autorizim dhe firmës prodhuese. Pra autorizimi i lëshuar nga firma “Universal” sh.p.k nuk është i plotë.

2. Operatori ekonomik “KADIU” sh.a., është konstatuar se:

- Për punonjësit motorrist, pompist, elektroauto dhe 1 (një) xhenerik janë paraqitur kontratat e punës ndërsa për dëshmi të kualifikimit profesional për këto specialitete janë paraqitur diploma të inxhinierëve mekanikë. Për 1 (një) xhenerik si dëshmi kualifikimi është paraqitur certifikatë për kursin profesional “Instalues dhe riparues kondicione reautomjeti”.
- Për punonjësit bojaxhi/llamarinist, ka paraqitur kontrata pune pa dëshmitë e kualifikimit profesional.
- Është paraqitur dokumentacioni që ka në pronësi ose me qera paisjen për kontrollin e bllokut të cilindrit të motorit dhe testatove (për çarje), por nuk është paraqitur foto për këtë pajisje.
- Nuk është paraqitur katalogu i fenelinës i shoqëruar me autorizim e prodhuesit ose të distributorit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

1.	“Vilnik Motors” sh.p.k. <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	L01314031G <i>numri i NIPT-it</i>
----	--	--------------------------------------

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 2,832,300 (dy milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind) lekë pa TVSH dhe vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj do të jetë 3,600,000 (tre milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Rr. “Abdi Toptani” Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen. Në momentin e paraqitjes duhet të sillni të gjithë dokumentacionin e paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.08.2020

Ankesa: Jo

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rudina Hoxha